

BLERJET ETIKE

A lidhet gjithçka me çmimin?

Shumë njerëz po i ndryshojnë zakonet e tyre të blerjeve, pasi po u përshtaten jetës në izolim gjatë pandemisë së koronavirusit. Ky mësim trajton pasojat e mundshme të këtyre ndryshimeve në sjelljen e konsumatorit për shoqërinë në tërësi dhe rolin që mund të luajë teknologjia, duke na ndihmuar të gjejmë mënyrat më të shëndetshme, më të drejta, më mjedisore dhe më të qëndrueshme të blerjeve.

Nxënësi do të jetë në gjendje:

- ▶ Të reflektojë mbi zakonet e blerjes në familjen e tyre dhe mbi mënyrat se si kanë ndryshuar këto zakone për shkak të pandemisë;
- ▶ Të analizojë arsyet e ndryshimit të zakoneve të blerjeve;
- ▶ Të identifikojë mënyra më të shëndetshme, më të drejta, më mjedisore dhe më të qëndrueshme blerjeje;
- ▶ Të zhvillojë kuptimin e drejtësisë dhe paanësisë e të menduarit kritik, si dhe kuptimin e ekonomisë, mjedisit dhe të qëndrueshmërisë.

STIMULIM

Anketë në grup:

Pyetini nxënësit se si ka ndryshuar mënyra e blerjes së ushqimeve në familjen e tyre që prej shpërthimit të pandemisë. Për shembull, a po blejnë ata:

- ▶ më shpesh, apo më rrallë?
- ▶ në dyqane të vogla, apo në supermarkete të mëdha?
- ▶ fizikisht/personalisht, apo *online*?

A po blejnë:

- ▶ më shumë, apo më pak ushqime?
- ▶ ushqime më të freskëta/të përpunuara, apo të shpejta e të gatshme (*fast food*)?

A po i kultivojnë më shumë vetë ushqimet e tyre? A po i gatujnë më shumë vetë ushqimet? A është çmimi më shumë, apo më pak i rëndësishëm? A ka pasur ndryshime të tjera?

Krijoni anketën tuaj. Në internet ka shumë platforma anketash *online* falas, p.sh. *Google Forms*.

Pasqyrojini të dhënat e anketës në grafik *online* ose kërkojuni nxënësve ta bëjnë këtë gjë.

DISKUTIM

Pas anketës:

- ▶ Çfarë të dhënash ju jep anketa për ndryshimet që ka pësuar blerja, që prej shpërthimit të virusit?
- ▶ Si mendoni, cilat janë arsyet e këtyre ndryshimeve?
- ▶ A mendoni se këto ndryshime do t'i bëjnë njerëzit:
 - më të shëndetshëm?
 - më të mirë për mjedisin?
 - më të drejtë për njerëzit që prodhojnë ushqime?
- ▶ Çfarë ndikon normalisht në zgjedhjet e njerëzve kur blejnë ushqime?
- ▶ Si mund të binden njerëzit që t'i marrin parasysh këta faktorë gjatë blerjeve?
- ▶ Cili është përgjegjës në shoqëri për të garantuar se ushqimi që ne blejmë është i shëndetshëm, i mirë për mjedisin dhe i drejtë për prodhuesit e ushqimit?

Jepni disa shembuj që i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë se çfarë është të mësuarit në grup, p.sh. diskutime, detyra të përbashkëta, hedhje idesh.

Sigurohuni që çështjet e aksesit në teknologji dhe aftësitë digjitale të dalin në diskutim.

PËRFUNDIM

Përmbledhni pikat kryesore të diskutimit.

Përsëritni idenë se kur blejmë ushqime, ne nuk vendosim duke u bazuar vetëm te çmimet dhe shijet, por zgjedhjet tona bazohen edhe rreth shëndetit, mjedisit dhe paanësisë e drejtësisë në shoqëri.

Përsëritni shkurtimisht fazat kryesore të zinxhirit të furnizimit ushqimor në vendin tuaj. Shpjegoni efektet që kanë zgjedhjet tona si konsumator mbi to.

Përpiquni të gjeni një infografik të përshtatshëm, p.sh. <https://www.futurelearn.com/courses/explore-how-farmers-produce-food-sustainably/0/steps/60769>

DETYRË

Nxënësit imagjinojnë sikur po ndihmojnë në projektimin e një aplikacioni, që konsumatorët mund ta përdorin për të udhëzuar zgjedhjet e tyre të blerjeve. Aplikacioni do të skanojë çdo produkt me barkod, duke i dhënë atij një klasifikim. Nxënësit duhet të zgjedhin një aspekt blerjeje që do të adresojë aplikacioni i tyre: pra, shëndetin, mjedisin ose drejtësinë. Ata hartojnë një listë me kritere, që do të përdoren nga aplikacioni dhe mbi bazën e të cilëve ai do të bëjë klasifikimin.

Ka shumë aplikacione të këtilla të disponueshme. Nxënësit më të mëdhenj mund të duan t'i analizojnë disa prej tyre ose madje edhe ta projektojnë një të tillë vetë. Shih <https://bit.ly/3axohWx>

REZULTATET

Nxënësit i paraqesin idetë e tyre për aplikacionin dhe shpjegojnë arsyet pas tyre.

Ata marrin në konsideratë përdorimet praktike të një aplikacioni të tillë dhe çfarë do ta bindte dikë të përdorë një aplikacion të tillë.

Ata reflektojnë mbi ndryshimet e formave të tjera të blerjes prej pandemisë dhe marrin në konsideratë implikimet etike të tyre, si p.sh. veshjet dhe moda.

Ose ata mund të diskutojnë avantazhet dhe disavantazhet e blerjeve *online* sa i përket shëndetit, mjedisit, drejtësisë.

Ky publikim është përkthyer dhe botuar në gjuhën shqipe në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës “Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri”, i financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

Mendimet e shprehura në këtë publikim janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

